



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 233

Tiranë – E premte, 2 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9862, datë 18.11.2016	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 24233
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 823, datë 23.11.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar..... 24233
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 23.11.2016	Për përcaktimin e formatit e të specifikimeve teknike të vulave të verifikimit kufitar dhe të rregullave të vendosjes së tyre në dokumentet e udhëtimit gjatë hyrje-daljeve në kufirin shtetëror..... 24234
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 825, datë 23.11.2016	Për rishpërndarjen e fondeve, brenda programeve, në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme..... 24237
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 826, datë 23.11.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar..... 24237
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 827, datë 23.11.2016	Për një shtesë në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”..... 24237
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 828, datë 23.11.2016	Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për kalimin e së drejtës së pronësisë, pa pagesë, mbi truallin dhe objektet e ndërtuara për familjet e shpërngulura nga ndërtimi i Ujëmbledhësit të Bovillës..... 24239
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 829, datë 23.11.2016	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për pagesën e kostove dhe shpenzimeve administrative për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. Arb/14/26, “Albaniabeg Ambient sh.p.k., M. Angelo Novelli dhe Costruzioni S.R.L. kundër Republikës së Shqipërisë”..... 24440

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 830, datë 23.11.2016	Për shfuqizimin e vendimit nr. 1068, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë, për ndërtimin e hidrocentralit “Katundi i Ri” mbi lumin Drini i Zi”.....	24440
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 831, datë 23.11.2016	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Bashkim Fino.....	24441
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 832, datë 23.11.2016	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Sherif Merdani.....	24441
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 833, datë 23.11.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rehabilitimi i stacionit të pompimit Trush (shtesa)”.....	24441
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 834, datë 23.11.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Kompleksi sportiv Lushnja”.....	24243
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të vdekur të shtetasit Veri Dika.....	24244
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasës Arsino Mersini.....	24244

**DEKRET**

Nr. 9862, datë 18.11.2016

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Luan Rexhep Gashi
2. Afrore Haki Bala (Morina)
3. Naid Adem Fejzullahu
4. Sabina Anvar Babayeva
5. Hasan Azem Ahmetaj
6. Zyrafete Mul Ahmetaj (Palushi)
7. Mohamed Mahmoud Saied Mostafa Elazizy
8. Ramazan Hüseyin Öncül
9. Fitore Asllan Lila (Lumi)
10. Yevgeniy Gennadiy Tikhonov
11. Selçuk Ali Arslan
12. Amzi Afiz Zimberi
13. Blerta Blerim Vula Rizvanolli (Rizvanolli)
14. Fabio Giuseppe Daneri
15. Anna Sergej Postoli (Kryuckova/Krijuçkova)
16. Besire Qazim Kastrati
17. Vasilika Vasil Mara (Diamandi)
18. Pëllumb Talat Gjinolli
19. Khaled Mostafa Zaki
20. Edmond Ahmet Rama
21. Nazanin Hassan Jannesar
22. Armond Mehdi Bytyqi
23. Leonidha Thoma Roça
24. Ali Rushit Salihu
25. Qendresa Ali Salihu
26. Ilir Rexhep Smailaj
27. Sabri Ali Maloku
28. Vlora Veli Domi (Avdiju)
29. Florentina Selim Shakaj (Murati)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 823, datë 23.11.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 914, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLAVE TË PROKURIMIT
PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullave të prokurimit publik, bashkëlidhur vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 60, “Urdhri i prokurimit”, fjalët “...të vitit ushtrimor...” zëvendësohen me “...të vitit buxhetor...”.

2. Në neni 76, “Kohëzgjatja e kontratës”, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“1. Autoriteti kontraktor, për fondet buxhetore, prokuron kontratat për një periudhë deri në mbylljen e vitit buxhetor, përveç rasteve kur lidhen kontrata shtesë, në përputhje me shkronjat “b”, të pikave 3 e 5, të nenit 33, të LPP-së.

Në çdo rast, financimi i kontratave të prokurimit bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.”.

b) Në nënndarjen e dytë, të pikës 3, fjalët “...brenda vitit ushtrimor...” zëvendësohen me “...brenda vitit buxhetor...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM

Nr. 824, datë 23.11.2016

PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT E TË SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË VULAVE TË VERIFIKIMIT KUFITAR DHE TË RREGULLAVE TË VENDOSJES SË TYRE NË DOKUMENTET E UDHËTIMIT GJATË HYRJE-DALJEVE NË KUFIRIN SHTETËROR¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 16, të ligjit nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vulat që përdoren nga rojat kufitare, për efekt të verifikimeve kufitare në hyrje dhe në dalje të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë, në vijim të këtij vendimi “vulat e hyrje-daljes”, kategorizohen si mall me natyrë të veçantë dhe prokurohen në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

2. Trupi dhe gjurma e vulave të hyrje-daljes është prej materiali metalik, i cili i reziston përdorimit të shpeshtë dhe për një kohë të gjatë.

3. Trupi i vulave të hyrje-daljes përmban mekanizëm të lëvizshëm, që mundëson ndërrimin e datarit dhe të kodit të sigurisë.

4. Specifikimet e gjurmës së vulave të hyrje-daljes klasifikohen “konfidenciale”.

5. Gjurma e vulave të hyrje-daljes përmban kodin e personalizuar, emrin e pikës përkatëse të kalimit kufitar, simbolin përkatës të mjetit të udhëtimit, në varësi të pikës së kalimit kufitar, dhe, në zonën ku vendosen shkronjat e simbolit të shtetit, përmban simbolin “AL”, të rrethuar nga një rreth.

6. Mënyra e përcaktimit të kodit të sigurisë së vulave të hyrje-daljes për secilën pikë të kalimit kufitar, mënyra e magazinimit, e ruajtjes, e sigurimit dhe e dorëzimit të vulave, për secilin turn dhe roja kufitare në pikat e kalimit kufitar, si dhe formati i

informacionit në lidhje me vulat e hyrje-daljes të dëmtuara, të humbura apo të vjedhura, rregullohen në Procedurat Standarde të Punës së Policisë Kufitare dhe Migracionit.

7. Kodi i sigurisë së vulave të hyrje-daljes ndërrohet në intervale të rregullta, jo më të gjata se një muaj.

8. Me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit përcaktohet një Pikë Kombëtare Kontakti, përgjegjëse për shkëmbimin e informacionit për kodet e sigurisë së vulave të hyrje-daljes. Pika Kombëtare e Kontaktit ka akses të menjëhershëm në informacionin për këto vula dhe, veçanërisht, për:

a) pikën e kalimit kufitar, në të cilën është dorëzuar një vulë e caktuar, dhe gjendjen fizike të saj;

b) identitetin e rojës kufitare, të cilit i është dhënë në dorëzim një vulë e caktuar, në një kohë të caktuar;

c) kodin e sigurisë së një vule të caktuar, në një kohë të caktuar.

9. Kërkimi i informacionit për vulat e hyrje-daljes, në përputhje me parashikimet e pikës 8, të këtij vendimi, kryhet nëpërmjet Pikës Kombëtare të Kontaktit.

10. Vulosja e pasaportës që nuk përmban vizë kryhet duke vendosur vulën e hyrjes në anën e majtë të faqes së parë të lirshme të pasaportës, duke filluar nga lart. Vula e daljes vendoset, parimisht, në të njëjtën faqe, përbri vulës së hyrjes.

11. Vulosja e pasaportës që ka një vizë, me të cilën personit i jepet e drejta e hyrjes, kryhet sipas parashikimit të pikës 10, të këtij vendimi, por vulosja fillon në faqen përballë faqes ku është vendosur viza. Nëse kjo faqe është e zënë, vulosja kryhet në faqen e lirë vijuese.

12. Vulat e hyrje-daljes në pasaportë nuk vendosen në faqet në të cilat pasqyrohen ose kërkohen shënime të tjera dhe në zonën e lexueshme nga aparaturat.

13. Në dokumentet e tjera, që janë përcaktuar për t'u vulosur sipas ligjit nr.71/2016, “Për kontrollin kufitar”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, vulat e hyrje-daljes vendosen në hapësirën e posaçme për vulosje ose në një pjesë të dukshme të dokumentit, kur nuk ka një hapësirë të tillë të posaçme.

14. Në rastet e refuzimit të hyrjes, në faqen e parë të lirshme të pasaportës vendoset një vulë

¹ Ky vendim është përafëruar pjesërisht me Rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)”, numri CELEX 32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.77, datë 23.3.2016, faqe 1–52.



hyrjeje, e cila anulohet me një kryq, që shkruhet me bojë që nuk del, siç tregohet në shtojcën 1/a, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e tij këtij vendimi, dhe përbri saj, në anën e dorës së djathtë, po me këtë lloj boje, shënohet shkronja ose shkronjat korresponduese për refuzimin e hyrjes, sipas formularit të refuzimit të hyrjes.

15. Kur vula e hyrjes ose e daljes vendoset gabimisht në një dokument apo paraqet të dhëna jo të sakta, ajo revokohet me dy viza paralele, me bojë që nuk del, të vendosura në këndin e sipërm të vulës, në anën e dorës së majtë, siç tregohet në shtojcën 1/b, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

16. Personat që kanë hyrë ose kanë dalë në mënyrë të ligjshme, por të cilëve u mungon vula në dokumentin e udhëtimit apo shënimet zyrtare përkatëse në sistemet elektronike, pajisen me formularin që vërteton hyrjen ose daljen e ligjshme, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, nga struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit, që evidenton e para rastin. Kjo strukturë kryen verifikimin e ligjshmërisë së hyrjes ose daljes së personit me anë të dokumenteve ndihmëse, si: bileta udhëtimi, lista udhëtarësh, shënime të tjera zyrtare, arkiva të ndryshme, etj., dhe bën, gjithashtu, shënimin për datën, vendin dhe drejtimin e kalimit të kufirit në dokumentin e udhëtimit të personit.

17. Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin, në bazë të nevojave të secilës pikë kalimi kufitar, harton listën e plotë të kërkesës për vula hyrjeje dhe daljeje, duke përfshirë kodet e personalizuara dhe simbolet përkatëse të mjetit të transportit për secilën vulë.


18. Vulat e nxjerra jashtë përdorimit ruhen dhe administrohen sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”.

19. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1/A
ANULIMI I VULËS SË HYRJES




Shtojca 1/b - Revokimi i vulës së hyrjes/daljes





Shtojca 2 : Formulari që zëvendëson mungesën e vulës ose të shënimit zyrtar të hyrjes/daljes



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
 Drejtoria e Policisë së Shtetit
 Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin
 Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin _____
 Sektori / Seksioni / Pika e Kalimit Kufitar _____

MIRATIM I DËSHMIVE / PROVAVE PËR RESPEKTIMIN E KUSHTEVE TË QËNDRIMIT AFATSHKURTËR NË RASTET KUR DOKUMENTI I UDHËTIMIT TË TË HUAJIT NUK MBART VULË HYRJEJE/DALJEJE OSE KUR NË SISTEMIN ELEKTRONIK TË PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE NUK KA SHËNIME ZYRTARE PËR HYRJEN / DALJEN E TË HUAJIT.

APPROVAL OF THE EVIDENCE REGARDING THE RESPECT OF THE CONDITION OF THE DURATION OF A SHORT STAY IN CASES ËHERE THE TRAVEL DOCUMENT OF THE ALIEN DOES NOT BEAR AN ENTRY / EXIT STAMP OR ËHEN THERE IS NOT ANY OFFICIAL RECORD OF ENTRY / EXIT IN THE ELECTRONIC DATA PROCESSING SYSTEM CONCERNING THE ALIEN.

Më _____, në orën _____, në (vendi) _____
 On _____, at (time) _____, at (place) _____,
 autoriteti nënshkrues _____ ka present:
 we, the undersigning authority, _____ have before us:
 (mbiemri) _____ (emri) _____
 (surname) _____ (first name) _____
 lindur më _____, në _____, të gjinisë _____
 date of birth _____, place of birth _____, sex _____
 me shtetësi _____, banues në _____
 nationality _____, Resident in _____
 me dokument udhëtimi _____, numër _____
 travel document _____, number _____
 lëshuar në, më _____
 issued in _____, on _____
 me numër vize (nëse është e zbatueshme), lëshuar nga _____
 visa number (if applicable) _____, issued by _____
 me afat _____ ditë, me motivin: _____
 for a period of _____ days, on the following grounds: _____.

Duke marrë parasysh provat që ka paraqitur lidhur me qëndrimin e tij / saj në territor, konsiderohet se ka hyrë në/ dalë nga RSH më _____, ora _____, Pika e Kalimit Kufitar _____.
 Having regard to the evidence relating to the duration of his/her stay on the territory, that he/she has provided is considered to have entered / left the territory of the Republic of Albania on _____, at _____, at the border crossing point _____.

Të dhënat e kontaktit të autoritetit nënshkrues:
 Contact details of the undersigning authority:
 Tel: _____
 Fax: _____
 e-mail: _____

Personi i interesuar pajiset me një kopje të këtij dokumenti
 The person concerned will receive a copy of this document

Personi i interesuar _____ Oficeri i autorizuar _____
 Person concerned Officer responsible _____
 _____ (vula / stamp)



VENDIM

Nr. 825, datë 23.11.2016

**PËR RISHPËRNDARJEN E FONDEVE,
BRENDA PROGRAMEVE, NË
BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E PUNËVE TË
BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme, bëhet rishpërndarja e fondeve, brenda programeve buxhetore, si më poshtë vijon:

a) Për programin “Policia e Shtetit”, në artikullin 231 “Shpenzime për investime”, shtohet fondi 63 000 000 (gjashtëdhjetë e tre milionë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve në investime për projektin “Sistemi i transmetimit të të dhënave DATACOM”;

b) Për programin “Emergjenca Civile”, në artikullin 602 “Mallra e shërbime”, shtohet fondi 14 400 000 (katërmëdhjetë milionë e katërqind mijë) lekë për mbulimin e shërbimeve të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë për fikjen e zjarreve në pyje gjatë muajit gusht-shtator 2016.

2. Fondi prej 77 400 000 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e katërqind mijë) lekësh, i përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b”, të këtij vendimi, përballohet nga pakësimi i buxhetit për programin “Gjendja civile”, zëri “Shpenzime për investime”, dhe për programin “Planifikim menaxhimi”, zëri “Shpenzime korrente”.

3. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 826, datë 23.11.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 418, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
MASËS SË SHPËRBLIMIT TË
ANËTARËVE TË KËSHILLAVE,
BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË
NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr.1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në ndarjen “Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës”, për emërtesat “Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha” dhe “Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave”, numri maksimal i pagesave në një vit buxhetor bëhet 12.

2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Infrastrukturës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 827, datë 23.11.2016

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
538, DATË 26.5.2009, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR LICENCAT DHE
LEJET QË TRAJTOHEN NGA APO
NËPËRMJET QENDRËS KOMBËTARE
TË LICENCIMIT (QKL) DHE DISA
RREGULLIME TË TJERA NËNLIGJORE
TË PËRBASHKËTA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15 e 36, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 48, 51, 75, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, me



propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhet shtesa si më poshtë vijon:

1. Pas fushës XII shtohet fusha XIII, me këtë përmbajtje:

“FUSHA XIII

TURIZMI

KATEGORIA XIII.1

AGJENCI UDHËTIMI DHE/OSE

OPERATOR TURISTIK

I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Veprimtaria “Agjenci udhëtimi dhe/ose Operator turistik” është kategoria XIII.1, e shtojcës së ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori, si më poshtë vijon:

a) “Agjenci udhëtimi”, me kodin XIII.1.A;

b) “Operator turistik”, me kodin XIII.1.B.

3. Licencat e të dy nënkategorive janë pa afat.

II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË XIII.1.A

1. Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse, për nënkategorinë A, jepen në tabelën 1, më poshtë:

Tabela 1

Kriteret e posaçme	Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme
Përshtatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit.	a) Drejtuesi teknik b) Përfaqësuesi ligjor (administratori)	a) Certifikatë për drejtuesin teknik ose përfaqësuesin ligjor; b) Akt që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës për drejtuesin teknik; c) Vërtetim të gjendjes gjyqësore për përfaqësuesin ligjor (administratorin) për 5 vitet e fundit.
Përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit.	a) Mjediset	Sipas rastit: dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, si dhe/ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e garancitë e këtyre faktorëve.

2. Licencimi i veprimtarisë së nënkategorisë A bëhet sipas grupit II.

III. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË XIII.1.B

1. Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse, për nënkategorinë B, jepen në tabelën 2, më poshtë:

Tabela 2

Kriteret e posaçme	Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme
Përshtatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit.	a) Drejtuesi teknik b) Përfaqësuesi ligjor (administratori)	a) Certifikatë për drejtuesin teknik; b) Certifikatë për përfaqësuesin ligjor (administratorin); c) Akt që provon marrëdhëniet e kërkuara të punës për drejtuesin teknik; ç) Vërtetim të gjendjes gjyqësore për përfaqësuesin ligjor (administratorin) për 5 vitet e fundit; d) Dokument që vërteton eksperiencën e mëparshme në këtë fushë të drejtuesit teknik dhe përfaqësuesit ligjor (administratorit).
Përshtatshmëria e pajisjeve, teknologjisë dhe mjediseve me standardet e shërbimit.	a) Mjediset	Sipas rastit: dokumente pronësie dhe/ose përdorimi, si dhe/ose dokumente që pasqyrojnë cilësitë e garancitë e këtyre faktorëve.

2. Licencimi i veprimtarisë së nënkategorisë bëhet sipas grupit II.

IV. DATA E FILLIMIT TË LICENCIMIT SIPAS KËTIJ VENDIMI

Data e fillimit të licencimit të veprimtarive të kategorisë XIII.1 është data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM

Nr. 828, datë 23.11.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
DHE TË AFATEVE PËR KALIMIN E SË
DREJTËS SË PRONËSISË, PA PAGESË,
MBI TRUALLIN DHE OBJEKTET E
NDËRTUARA PËR FAMILJET E
SHPËRNGULURA NGA NDËRTIMI I
UJËMBLEDHËSIT TË BOVILLËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/1, të nenit 39/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi truallin dhe ndërtimet e subjekteve të shpërngulura nga ndërtimi i Ujëmbledhësit të Bovillës, kryhet, pa pagesë, sipas listave të hartuara në bazë të vendimit nr. 85, datë 2.3.1994, të Këshillit të Ministrave, “Për vënien në dispozicion të zonave të banimit për familjet që shpërngulen nga Ujëmbledhësi i Bovillës dhe ato që kanë ndërtuar pa leje përreth qytetit të Tiranës”.

2. Titulli i pronësisë për objektin dhe truallin fitohet nëpërmjet lejes së legalizimit, e cila është e vlefshme për regjistrim në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

3. Procedurat për dhënien e lejes së legalizimit kryhen sipas gjendjes ndërtimore faktike, të evidentuar në terren, përfshirë ndryshimet apo shtesat informale të realizuara në objekt.

4. Drejtoria përkatëse e ALUIZNI-t i kërkon njësisë së qeverisjes vendore listat e plota të subjekteve të shpërngulura nga ndërtimi i Ujëmbledhësit të Bovillës, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Njësia e qeverisjes vendore përcjell listat e subjekteve brenda 10 (dhjetë) ditëve nga administrimi i kërkesës.

5. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Drejtoria përkatëse e ALUIZNI-t kryen evidentimin në terren të objekteve dhe verifikimin nëse ka aplikime për legalizim duke plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në pikën 1, të vendimit nr. 589, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit faktik, në terren, të ndërtimeve pa leje/shtesave në ndërtime

me leje, të organeve dhe dokumentacionit për propozimin dhe miratimin e zonave informale”, të ndryshuar.

6. Drejtoria e ALUIZNI-t, gjatë procedurës së evidentimit në terren, sipas rastit, administron dhe dokumentacionin si më poshtë vijon:

a) Kopje të dokumentit të identifikimit;

b) Certifikatën e përbërjes familjare në datën 2.3.1994;

c) Deklaratën sipas pikës 2, të vendimit nr. 589, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar;

ç) Dëshminë e trashëgimisë (nëse subjekti nuk jeton më);

d) Çdo dokument tjetër ligjor për të drejtat civile mbi ndërtimin, nëse subjekti e disponon.

7. Konfigurimi i sipërfaqes së truallit përcaktohet nga ALUIZNI, duke i pasqyruar në genplanin përkatës. Sipërfaqja e truallit që përfitohet, pa pagesë, është sipas masës së vënë në dispozicion në zbatim të vendimi nr. 317, datë 19.6.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për sistemimin me tokë bujqësore dhe truall ndërtimi të fshatrave Zallmner, Bulcesh dhe Brurëz”, të ndryshuar.

Mosmarrëveshjet dhe pretendimet mbi masën e sipërfaqes së truallit ose konfigurimin e tij, shqyrtohen nga gjykata kompetente.

8. Objektet dhe trojet që kalohen në pronësi sipas këtij vendimi, nuk i nënshtrohen kriterëve dhe procedurave kualifikuese të përcaktuara në vendimin nr. 280, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përfundimi i procedurave sipas pikave 5 dhe 6, të këtij vendimi, Drejtoria e ALUIZNI-t miraton lejen e legalizimit, në favor të subjekteve në moshë madhore në kohën e shpërnguljes, sipas certifikatës së përbërjes familjare të datës 2.3.1994, ose të trashëgimtarëve të tyre.

10. Aplikimi për regjistrimin e pasurisë kryhet sipas vendimit nr. 1095, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”. ZVRPP-ja Tiranë,



brenda 10 (dhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës për regjistrim nga ALUIZNI, kryen regjistrimin përfundimtar të pronësisë mbi truallin dhe ndërtesën për të cilën është lëshuar leja e legalizimit.

11. Për efekt të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, Drejtoria e ALUIZNI-t zbaton përcaktimet e pikës 5, të vendimit nr. 860, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, të ndryshuar.

12. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Bashkia Kamzë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 829, datë 23.11.2016

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR
PAGESËN E KOSTOVE DHE
SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE PËR
ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT
NDËRKOMBËTAR NR. ARB/14/26,
“ALBANIABEG AMBIENT SHPK, M.
ANGELO NOVELLI DHE COSTRUZIONI
S.R.L. KUNDËR REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2016, t’i shtohet fondi 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) dollarë, për të përballuar kostot dhe shpenzimet administrative për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. ARB/14/26, “Albaniabeg Ambient sh.p.k., M. Angelo Novelli dhe Costruzioni S.R.L. kundër Republikës së Shqipërisë”, që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit (ICSID).

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, t’i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën, i konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën kur do të kryhet pagesa.

3. Ky efekt financiar të përballohet nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2016.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 830, datë 23.11.2016

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.
1068, DATË 23.12.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
BONUSIT NË PROCEDURËN
PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I
JEPET SHOQËRISË, PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALIT “KATUNDI I RI”
MBI LUMIN DRINI I ZI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 25, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 1068, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse



konkurruese, që i jepet shoqërisë, për ndërtimin e hidrocentralit “Katundi i Ri” mbi lumin Drini i Zi”.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 831, datë 23.11.2016

PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. BASHKIM FINO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 33, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Bashkim Fino, në masën 1 100 000 (një milion e njëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 832, datë 23.11.2016

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. SHERIF MERDANI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 33, datë 20.1.2016, të Këshillit të

Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Sherif Merdani, në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 833, datë 23.11.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I STACIONIT TË POMPIMIT TRUSH (SHTESA)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rehabilitimi i stacionit të pompimit Trush (shtesa)”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të ndërmarrjes “Ujësjetës fshat” sh.a., Shkodër.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën



bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, me sipërfaqe 2 960 (dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) m², me vlerë të përgjithshme të shpronësimit 799 200 (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 799 200 (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i ndërmarrjes “Ujësjetllës fshat” sh.a., Shkodër.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i ndërmarrjes “Ujësjetllës fshat” sh.a., Shkodër.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë ndërmarrjes “Ujësjetllës fshat” sh.a., Shkodër.

8. Ndërmarrja “Ujësjetllës fshat” sh.a., Shkodër, të kryejë likuidimet për efekt shpronësimi në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij

vendimi, në bashkëpunim me ndërmarrjen “Ujësjetllës fshat” sh.a., Shkodër, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga ndërmarrja “Ujësjetllës fshat” sh.a., Shkodër, dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, ndërmarrja “Ujësjetllës fshat” sh.a., Shkodër, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QË PREKEN NGA PROJEKTI “REHABILITIMI I STACIONIT TË POMPIMIT TRUSH-SHKODËR”(SHITESA)

Nr.	Emri - Atësia - Mbiemri	Z. Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. e shpronësimit (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)
1	Nazif Halit Pervizi	3205	1298/3	arë	775	270	209250
2	Zija Halit Pervizi	3205	1298/4	arë	1700	270	459000
3	Arif Selim Mustafaj	3205	1298/45	arë	485	270	130950
		SHUMA TOTALE					799200



VENDIM

Nr. 834, datë 23.11.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “KOMPLEKSI SPORTIV LUSHNJA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Kompleksi Sportiv Lushnja”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “tokë truall”, me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 37 964 960 (tridhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 37 964 960 (tridhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekësh, të përballohet nga llogaria

“Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronari i përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasurinë e shpronësuar.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

KËNDI SPORTIV NË LAGJEN “SKËNDER LIBOHOVA”, LUSHNJË

Nr.	Nr. i pas.	Zona kadastrale	Lagja	Emër Mbiemër	Lloji	m ²	Çmimi	Vlera	Konfirmim nga ZVRPP-ja
1		8572	“S. Libohova”	Shefqet Dervishi + bashkëpronar	Truall	4240	8954	37964960	Shkresë 7161/1, datë 16.8.2016
TOTALI								37964960	



VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 1193, datë 2.11.2016 vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Veri Dika me 1 dhjetor të vitit 1991.

KËRKESË

Shtetasja Merushe Mersini, lindur në Qarrë, Fier dhe banuese në Levan, Fier kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasës Arsino Mersini e datëlindjes 4.5.1979, lindur e banuese në lagjen 1 Maji, Levan, bashkia Fier.

KËRKUESE
Merushe Mersini

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 042427006

Çmimi 140 lekë